

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
MINISTRIA E EKONOMISE  
MINISTARSTVO EKONOMIJE  
MINISTRY OF ECONOMY

Nr. Prof. 4M  
Br. Prof. Prof.No.  
Data 13.03.2026  
Date

Nr. Org. 01/3  
Org. Jedin  
Org. Unit  
No. Ispisnice  
Broj Ispisnice  
No. of copies

PRISHTINE A NO.1

Hidromorava  
Gjilan

Kompania Rajonale e Ujësjetësit  
"Hidromorava"  
Gjilan



Hidromorava KOMPANIA RAJONALE  
Gjilan E UJËSJETËSIT  
HIDROMORAVA Sh.a.  
No. 172 Data 27.02.2026  
GJILAN

# RAPORT VJETOR

## 2025



[www.kru-hidromorava.com](http://www.kru-hidromorava.com)

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. HYRJE</b>	<b>1</b>
1.1 Vizioni, objektivat dhe strategjitë kyçe .....	1
<b>2. BORDI I DREJTORËVE</b>	<b>2</b>
2.1 Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin .....	2
2.2 Vendimet e Bordit të Drejtorëve .....	2
2.3 Përbushja e detyrimeve ligjore.....	4
2.4 Të dhëna për drejtorët jo - ekzekutiv.....	5
2.5 Numri i takimeve të Bordit gjatë vitit dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e Bordit.....	6
2.6 Komisionet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura .....	6
<b>3. KRYESHEFI EKZEKUTIV</b>	<b>9</b>
3.1. Aktivitetet kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv .....	9
3.2. Aktivitetet e tjera të Kryeshefit Ekzekutiv.....	10
<b>4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV</b>	<b>12</b>
4.1. Aktivitetet e Zyrës së Sekretares së Ndërmarrjes gjatë vitit 2025 .....	12
4.2. Struktura organizative e KRU "Hidromorava" Sh.A. ....	12
4.2.1. Procedurat e rekrutimit.....	13
4.3. Përmbledhje e procedurave gjyqësore të KRU "Hidromorava" Sh.A.....	14
4.4. Arkivi .....	15
<b>5. DEPARTAMENTI FINCIAR</b>	<b>16</b>
5.1. Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën .....	16
5.2. Dividenda të paguara gjatë vitit 2025 .....	17
5.3. Një shqyrtim i performancës afariste dhe financiare për vitin 2025 .....	17
5.4. Draft pasqyra e pozitës financiare me datë 31.12.2025.....	17
5.5. Draft pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2025 .....	19
5.6. Draft pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 .....	20
5.7. Draft pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 .....	21
5.8. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin 2025 .....	22
5.9. Shpalosje e pasqyrës së rrjedhës së parasë.....	29
5.10. Raporti vjetor i performancës operative dhe financiare .....	32
5.10.1. Pasqyrat e implementimit të planit të biznesit dhe raporti krahasues me vitin paraprak .....	32
5.11. Prodhimi i ujit .....	33
5.12. Faturimi i ujit në m <sup>3</sup> .....	33
5.13. Faturimi i ujit në euro (€).....	34
5.14. Arkëtimi i ujit në euro (€).....	34
5.15. Përqindja e arkëtimit .....	35
5.16. Shpenzimet operative .....	35
5.17. Konsumatorë të regjistruar.....	37
5.18. Konsumatorët aktivë me ujëmatës .....	37

5.19.	Konsumatorët pa ujëmatës .....	38
5.20.	Numri i konsumatorëve aktivë.....	38
5.21.	Faturimi i ujit me ujëmatës.....	39
5.22.	Investimet vetanake .....	39
<b>6.</b>	<b>PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS VJETORE PËR 2025 NGA DEPARTAMENTI FINANCIAR</b>	<b>40</b>
<b>7.</b>	<b>RAPORTI I ZYRËS SË PROKURIMIT</b>	<b>41</b>
<b>8.</b>	<b>RAPORTI I DIVIZIONIT PËR CILËSINË E UJIT</b>	<b>44</b>
8.1.	Cilësia e ujit .....	44
<b>9.</b>	<b>RAPORTI I PUNËS SË DEPARTAMENTIT TEKNIK</b>	<b>46</b>
9.1.	Divizioni për prodhimin, impiantet e ujit dhe stacionet e pompimit.....	46
9.1.1.	Furnizimi me ujë .....	46
9.1.2.	Prodhimi, faturimi dhe UPF i ujit në KRU "Hidromorava" - Sh.A. ....	47
9.1.3.	Uji i pafaturuar (UPF) .....	48
9.2.	Divizioni i rrjetit të ujësjellësit .....	49
9.2.1	Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit .....	49
9.2.2	DMA - zonat .....	50
9.3.	Divizioni i mirëmbajtjes së ujërave të ndotura .....	52
9.3.1	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit .....	52
9.4.	Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve .....	52
9.4.1	Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 .....	52
9.4.2	Projektet ndërkombëtare .....	53
9.4.3	Projektet vetanake .....	54
9.4.4	Projektet e rëndësishme të KRU "Hidromorava" gjatë vitit 2025 .....	55

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025 .....	2
Tabela 2. Përbërja e Bordit të Drejtorëve, pozitat dhe kompensimet nga data: 01.01.2025 deri 31.12.2025 .....	6
Tabela 3. Investimet vetanake gjatë vitit 2025 .....	16
Tabela 4. Investimet nga donatorët gjatë vitit 2025 .....	17
Tabela 5. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë .....	22
Tabela 6. Stoqet .....	23
Tabela 7. Pasuritë tjera afatshkurtra .....	24
Tabela 8. Prona, pajisjet dhe impiantet.....	24
Tabela 9. Zhvlerësimi gjatë vitit 2025.....	25
Tabela 10. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera për 2025 dhe krahasimi me vitin 2025 .....	25
Tabela 11. Të hyrat e shtyra .....	27
Tabela 12. Treguesit operativë.....	30
Tabela 13. Treguesit financiar .....	31
Tabela 14. Treguesit e performancës .....	32
Tabela 15. Shpalosje e shpenzimeve 2025/2024 .....	36
Tabela 16. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2025 - "vlerë minimale".....	41
Tabela 17. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2025 - "procedurë e hapur - kuotim i çmimit" .....	41
Tabela 18. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2025 - "vlerë e madhe" .....	42
Tabela 19. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2025 - "procedurë e hapur - vlerë e mesme" .....	42
Tabela 20. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2025 - "Aneks Kontratë" .....	43
Tabela 21. Analizat e cilësisë së ujit gjatë vitit 2025 .....	44
Tabela 22. Vëllimi i ujit në varësi të nivelit të ujit në akumulacion gjatë vitit 2025 .....	47
Tabela 23. Të dhënat e paraqitura për UPF-në, në nivel regjioni për vitin - 2025 .....	48
Tabela 24. Intervenimet në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit.....	50
Tabela 25. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë vitit 2025 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit .....	51
Tabela 26. Intervenimet në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe pastrimit të pusetave .....	52
Tabela 27. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë vitit 2025.....	53
Tabela 28. Raport mbi statusin e disa prej projekteve të rëndësishme të menaxhuara nga KRU "Hidromorava" Sh.A. ....	55

## LISTA E SHËNIMEVE

Shënim nr. 1 - Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë.....	22
Shënim nr. 2 - Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat e tjera.....	23
Shënim nr. 3 - Stoqet.....	23
Shënim nr. 4 - Pasuritë tjera afatshkurtra.....	24
Shënim nr. 5 - Prona, pajisjet dhe impiantet.....	24
Shënim nr. 6 - Investimet në vijim/projektet.....	25
Shënim nr. 7 - Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera për 2025 .....	25
Shënim nr. 8 - Detyrimet afatshkurtra .....	27
Shënim nr. 9 - Gjithsej detyrimet afatshkurtra.....	27

Shënim nr. 10 -Të hyrat e shtyera.....	27
Shënim nr. 11 dhe 12 - Kapitali aksionar, fitimet e mbajtura, rezervat e kapitalit - Ekuiteti.....	27
Shënim nr. 13 dhe 14 - Të hyrat dhe grantet.....	28
Shënim nr. 15 - Shpenzimet e shpërndarjes.....	28
Shënim nr. 16 - Shpenzimet e zhvlerësimit.....	28
Shënim nr. 17 - Shpenzimet administrative të tjera.....	28
Shënim nr. 18 - Fitimi (humbja) para tatimit/fitimi (humbja) e vitit.....	29
Shënim nr. 19 - Fitimi/humbja e vitit - shpalosje në shënimin nr.20.....	29
Shënim nr. 20 - Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve - shpalosje në shënimin nr.5.....	29
Shënim nr. 21 - Rritje/zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme - shpalosje shënimi nr.2.....	29
Shënim nr. 22 - Rritje/zvogëlim në stoqe - shpalosje shënimi 3.....	30
Shënim nr. 23 - Rritje/zvogëlim në pasuritë e tjera - shpalosje shënimi nr. 4.....	30
Shënim nr. 24- Rritje/zvogëlim në llogaritë e pagueshme tregtare - shpalosje shënimi nr. 8.....	30
Shënim nr. 25- Rritje/zvogëlim në detyrimet e tjera - shpalosje në shënimin nr. 9.....	30

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Struktura e të punësuarve sipas njësive operative gjatë vitit 2025.....	13
Grafiku 2. Struktura e të punësuarve sipas gjinisë.....	13
Grafiku 3. Prodhimi i ujit.....	33
Grafiku 4. Faturimi i ujit m <sup>3</sup> .....	33
Grafiku 5. Faturimi i ujit në euro (€).....	34
Grafiku 6. Arkëtimi i ujit në euro (€).....	34
Grafiku 7. Përqindja e arkëtimit.....	35
Grafiku 8. Shpenzimet operative.....	35
Grafikoni 9. Konsumator të regjistruar.....	37
Grafiku 10. Konsumatorë aktivë me ujëmatës.....	37
Grafiku 11. Konsumatorët pa ujëmatës.....	38
Grafiku 12. Numri i konsumatorëve aktivë.....	38
Grafiku 13. Faturimi i ujit me ujëmatës (m <sup>3</sup> ).....	39
Grafiku 14. Investimet vetanake.....	39
Grafiku 15. Niveli i ujit në akumulacionin e Përlepticës gjatë vitit 2025.....	46
Grafiku 16. Prodhimi i ujit sipas burimeve gjatë vitit 2025.....	48
Grafiku 17. UPF gjatë vitit 2025.....	49

## FJALORI I AKRONIMEVE/SHKURTESAVE

ARRU	Autoriteti Rregullator i Ujërave
B.I.	Biznes Individual
DMA Zona	District Metered Area (Zona e Matjes së Rrjetit/Ujësjesit)
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (shqip. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)
FLAWS	Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security (shqip: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë Ujore)
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GIS	Geographic Information System (Sistemi Gjeografik i Informacionit)
GOPA	Gesellschaft für Organisation, Planung und Ausbildung (Shoqëria për Organizim, Planifikim dhe Trajnim).
HM	Hidromorava
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IMF	Institucionet mikrofinanciare
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
KESCO	Kompania për shpërndarjen e Energjisë Elektrike të Kosovës
KIWER	Kosovar Institute for Water and Environmental Research (Instituti Kosovar për Kërkime në Fushën e Ujit dhe Mjedisit)
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjesit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NTSh	Ndërmarrje Tregtare Shoqërore
Nj.O.	Njësi Operative e KRU Hidromorava Sh.A.
Sh.A.	Shoqëri Aksionare
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
SHUKOS	Shoqata e Ujësjesave dhe Kanalizimeve të Kosovës
SHUKALB	Shoqata e Ujësjesave dhe Kanalizimeve të Shqipërisë
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UPF	Uji i pafaturuar
OE	Operator Ekonomik

## 1. HYRJE

### 1.1 Vizioni, objektivat dhe strategjitë kyçe

Raporti vjetor i punës për vitin 2025 i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidromorava Sh. A. paraqet një pasqyrë të plotë të aktiviteteve, arritjeve dhe sfidave me të cilat është përballur Ndërmarrja gjatë vitit të kaluar. Ky raport është përgatitur në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, Kodit të Etikës si dhe Udhëzuesit nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Përpilimi i tij është realizuar duke u bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe në kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi në Republikën e Kosovës.

Duke marrë parasysh rëndësinë e zbatimit të standardeve ligjore dhe rregullatore, raporti fokusohet në përgjegjësitë dhe detyrimet e ndërmarrjes publike, të cilat janë të përcaktuara qartë brenda kornizës ligjore në fuqi. Bazuar në këtë kornizë, ndërmarrja operon në përputhje me ligjet kryesore që rregullojnë veprimtarinë e saj, përfshirë:

- Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, me Ligjin nr. 05/L-009 si dhe me Ligjin Nr. 08/L-276.

Ky raport shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së ndërmarrjes, duke identifikuar arritjet, sfidat dhe masat e nevojshme për të përmirësuar shërbimet dhe menaxhimin në përputhje me objektivat strategjike dhe kërkesat ligjore.

Si ofruesi kryesor i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të zeza në rajon, kompania është e përkushtuar të sigurojë ujë të pastër dhe cilësor për qytetarët, duke ndjekur standardet më të larta të menaxhimit dhe shërbimit.

Gjatë vitit 2025, KRU Hidromorava ka punuar intensivisht për të përmirësuar infrastrukturën e rrjetit të ujësjetës, me qëllim rritjen e efikasitetit operativ dhe adresimin e sfidave të lidhura me menaxhimin e burimeve ujore. Përmes këtij raporti, synohet të ofrohet transparencë mbi aktivitetet e realizuara, duke paraqitur të dhëna të detajuara mbi performancën financiare, investimet, projektet zhvillimore dhe përmirësimet në cilësinë e shërbimeve.

Duke falënderuar Ministrinë e Ekonomisë në cilësinë e Aksionarit, Komunitet përkatëse, të gjithë partnerët, donatorët, punonjësit, konsumatorët si dhe Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, KRU Hidromorava Sh.A. mbetet e përkushtuar në përbushjen e misionit të saj për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë për të gjithë qytetarët.

## 2. BORDI I DREJTORËVE

### 2.1 Mbledhja e përgjithshme vjetore me aksionarin

Duke pasur parasysh që Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin është pjesë e mekanizmit zyrtar të qeverisjes korporative gjatë së cilës demonstron llogaridhënia për performancën e Ndërmarrjes dhe rezultatet e vitit të kaluar kalendarik, Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" Sh.A., me datë 13.10.2025, ka mbajtur Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në pajtim me nenin 179 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-06 mbi Shoqëritë Tregtare. Në këtë mbledhje kanë qenë prezent edhe përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, konkretisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Gjatë Mbledhjes së Përgjithshme me Aksionarin janë shqyrtuar këto pika të rendit të ditës:

- Miratimi i Raportit të Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 dhe Letrës për Menaxhmentin;
- Miratimi i Raportit Vjetor të punës për vitin 2024;
- Performanca e Menaxhmentit të Ndërmarrjes; dhe
- Të ndryshme.

### 2.2. Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike, duke respektuar të drejtën e lirë dhe pa presion të votimit dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit. Duke u bazuar në këtë, Bordi i Drejtorëve gjatë periudhës raportuese ka marrë këto vendime:

Tabela 1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025

Nr.	Vendimi	Nr. vendimit	Data e protokollimit
1.	Vendim për miratimin e propozimit të Menaxhmentit për rritjen e pagave të të punësuarve në mënyrë lineare nga 0.15 njësi të koeficientit apo në vlerë monetare 36.00€ duke filluar nga 1 janari 2025 dhe nga 0.15 njësi të koeficientit apo në vlerë monetare 36.00€ duke filluar nga 1 korriku 2025.	62	23.01.2025
2.	Vendim për miratimin e Raportit të punës për tremujorin e katërt për vitin 2024" të KRU "Hidromorava" Sh.A, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve mbajtur me datë: 25.02.2025.	166	26.02.2025
3.	Vendim për miratimin e Raportit Vjetor për vitin 2024 të KRU "Hidromorava" Sh.A. me datë: 12.03.2025 përmes postës elektronike.	391	12.03.2025
4.	Vendim për miratimin e Raportit Vjetor për vitin 2024 me ndryshime/plotësime të KRU "Hidromorava" - Sh.A., në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve mbajtur me datë: 26.03.2025.	454/1	28.03.2025
5.	Vendim për miratimin e "Raportit për hulumtimin e kënaqshmërisë së konsumatorëve për vitin 2024 të KRU "Hidromorava" Sh.A." me datë: 31.03.2025 përmes postës elektronike.	458	01.04.2025

6.	Vendim për emërimin e znj. M.Xh. në cilësinë e Ushtruesës së Detyrës në pozitën Zyrtare e Lartë Financiare dhe të Thesarit nga data: 01.04.2025 deri në përzgjedhjen e kandidatit përmes konkursit publik.	482	04.04.2025
7.	Vendim për miratimin e "Kërkesës për Ri-alokim të mjeteve të Planit e Biznesit për vitin 2025" të KRU "Hidromorava" Sh.A. me datë: 07.05.2025 përmes postës elektronike.	652	08.05.2025
8.	Vendim për miratimin e "Raportit të punës për tremujorin të parë për vitin 2025 të KRU "Hidromorava" Sh.A", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 28.05.2025	715	30.05.2025
9.	Vendim për miratimin e "Raportit të Auditimit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2024", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve mbajtur me datë: 28.05.2025, e cila është konfirmuar edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Kuvendit të Aksionarit të mbajtur me datë: 13.10.2025.	715/1	30.05.2025
10.	Vendim për miratimin e "Rishikimit të Planit të Biznesit për vitin 2025 (me ndryshime/plotësime)", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 29.07.2025.	891	29.07.2025
11.	Vendim për vazhdimin e mandatit të z. Ymer Salihu në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv për një periudhë tre (3) vjeçare, duke filluar nga data 01.08.2025 deri më 31.07.2028, me mundësi vazhdimi.	892	29.07.2025
12.	Vendim për shpalljen e Konkursit Publik për pozitën e "Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit".	893	29.07.2025
13.	Vendim për rritjen e vlerës së shujtës ditore për të punësuarit e KRU "Hidromorava" Sh.A. nga tre (3) euro në katër (4) euro për çdo ditë pune nga data: 01.08.2025.	895	29.07.2025
14.	Vendim për miratimin e "Raportit të punës për tremujorin e dytë për vitin 2025 të KRU "Hidromorava" Sh.A", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 27.08.2025.	1092	27.08.2025
15.	Vendim për përzgjedhjen e z. Albion Ramadani si kandidati më i suksesshëm për pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit" në KRU "Hidromorava" Sh.A. sipas Konkursit Publik Nr. 894 i dt. 29.07.2025.	1294	17.09.2025
16.	Vendim për emërimin e z. Albion Ramadani në pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit" në KRU "Hidromorava" Sh.A. me mandat tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi.	1467	31.10.2025
17.	Vendim për miratimin e "Planit të Biznesit për vitin 2026 - 2028 të KRU "Hidromorava" Sh.A." në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 31.10.2025.	1469	31.10.2025
18.	Vendim për miratimin e "Raportit të punës për tremujorin e tretë për vitin 2025 të KRU "Hidromorava Sh.A.", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 26.11.2025.	1534	26.11.2025

19.	Vendim për ofrimin e mbështetjes financiare në vlerë prej: 150.00€ për të gjithë të punësuarit si formë përkrahje financiare dhe sociale dhe në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi institucional për punën dhe angazhimin e tyre.	1636	23.12.2025
20.	Vendim për miratimin e "Kodin e Etikës Profesionale dhe Standardit të Veshjes në KRU "Hidromorava" Sh.A, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 23.12.2025.	1637	23.12.2025
21.	Vendim për miratimin e "Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRU "Hidromorava" Sh.A, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 23.12.2025.	1638	23.12.2025

### 2.3. Përbushja e detyrimeve ligjore

Me qëllim të përbushjes së objektivave dhe politikave zhvillimore të vendosura nga Aksionari për të drejtuar Ndërmarrjen drejt suksesit, Bordi i Drejtorëve ka vepruar në mënyrë efikase dhe kolegjinale, si një ekip, brenda kornizës ligjore dhe rregullative. Gjatë vitit 2025, Bordi ka përbushur me përgjegjësi të gjitha detyrimet ligjore për raportime të rregullta, të cilat rrjedhin nga Ligji për Ndërmarrjet Publike.

Raporti Vjetor për vitin 2024, i miratuar nga Bordi i Drejtorëve më datë 12.03.2025 përmes postës elektronike, si dhe ndryshimi/plotësimi i Raportit Vjetor të KRU "Hidromorava" – Sh.A., i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më datë 26.03.2025, përbushin kërkesat ligjore në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Ky raport ofron një pasqyrë të plotë të aktiviteteve dhe performancës së Ndërmarrjes gjatë vitit të kaluar duke përfshirë edhe arritjet operacionale të secilës njësi operative. Raporti ofron një vlerësim të ekuilibruar dhe të qartë të performancës së ndërmarrjes dhe përshkruan perspektivat për të ardhmen.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 është kryer nga Kompania e Licencuar "H&N" Sh.P.K., Prishtinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Auditimi është përfunduar brenda afatit ligjor të përcaktuar dhe, bazuar në raportin e auditorit, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2025 ka miratuar Raportin e Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024. Ky vendim është konfirmuar edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Kuvendit të Aksionarit, të mbajtur më datë 13.10.2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Raporti i Auditorit të Pavarur për KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan për vitin 2024, jep Opinion të Kualifikuar lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Baza për opinionin e dhënë nga auditorët është përshkruar në paragrafin "Opinion i kualifikuar", ku thuhet se pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale (ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë) për pozicionin financiar të Ndërmarrjes më 31 dhjetor 2023, rezultatin financiar dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar (SNRF).

Bordi i Drejtorëve ka miratuar "Rishikimit të Planit të Biznesit për vitin 2025 (me ndryshime/plotësime)", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 29.07.2025 dhe "Planin e Biznesit për vitet 2026 - 2028 të KRU "Hidromorava" Sh.A." në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 31.10.2025, konform nenit 17 të Ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Bazik nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

**Shënim:** Raporti Vjetor dhe raportet tre mujore në formë të njoftimit i janë dërguar edhe Kryetarëve të Komunave të Gjilanit, të Kamenicës dhe të Vitisë, pasi që Ndërmarrja jonë ushtron veprimtarinë e saj në këto komuna dhe e tërë kjo konform nenit

31 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshim plotësim nga Ligji Nr.04/L-111, si dhe me ndryshim plotësim nga Ligji Nr.05/L-009.

## 2.4. Të dhëna për drejtorët jo – ekzekutiv

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, si dhe të nenit 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me Nenin 19 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.03.2022 pas një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, ekskluzivisht në bazë të meritave, për KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan më datë 09.03.2022 merr vendimin nr. 09/67 për emërimin e Bordit të Drejtorëve me këtë përbërje:

- Z. Habil Zeqiri- Kryesues i Bordit të Drejtorëve;
- Znj. Filloretë Gashi Sadiku – anëtare e Bordit të Drejtorëve;
- Znj. Ferdane Tahiri Sylejmani – anëtare e Bordit të Drejtorëve;
- Z. Arban Hoxha – anëtar i Bordit të Drejtorëve;
- Znj. Lindita Fazli – anëtare e Bordit të Drejtorëve dhe
- Z. Agim Zeka – anëtar i Bordit të Drejtorëve.

Ndërsa, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, si dhe të nenit 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me Nenin 19 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë: 16.11.2023, merr vendimin 03/173 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 09/67 të datës: 09.03.2022 për emërimin e Bordit të Drejtorëve si në vijim:

- Znj. Filloretë Gashi Sadiku – Kryesuese e Bordit të Drejtorëve dhe
- Z. Habil Zeqiri - anëtar i Bordit të Drejtorëve;

Me datë 24.03.2025, znj. Filloretë Gashi Sadiku ka ofruar dorëheqjen e saj nga pozita e Kryesueses/Anëtares së Bordit të Drejtorëve të KRU "Hidromorava" Sh.A., përmes postës elektronike. Pas kësaj dorëheqjeje, Ministria e Ekonomisë, me datë 21.05.2025, në mbështetje të neneve 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe të nenit 15 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në pajtim me pikat 13.6 dhe 13.7 të Shtojcës së Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, ka marrë Vendimin nr. 2231 (protokoll i ME), të datës 21.05.2025, për caktimin e

- Z. Habil Zeqiri – Ushtrues Detyre i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KRU "Hidromorava" Sh.A., deri në emërimin e Kryesuesit ose emërimin e Bordit të ri të Drejtorëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Tabela 2. Përbërja e Bordit të Drejtorëve, pozitat dhe kompensimet nga data: 01.01.2025 deri 31.12.2025

Nr.	Emri e Mbiemri	Pozita	Kompensimi		
			BD	KA	
1.	Fillorete Gashi Sadiku	Kryesuese e Bordit të Drejtorëve <sup>1</sup>	450 €	-	-
2.	Habil Zeqiri	Ushtrues Detyre i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve	320 € <sup>2</sup>		
3.	Ferdane Tahiri Sylejmani	Kryesuese e Komisionit të Auditimit	320 €	110€	430€
4.	Lindita Fazliu	Anetare e Bordit të Drejtorëve	320 €	80€	400€
5.	Arban Hoxha	Anëtar i Bordit të Drejtorëve		80€ <sup>3</sup>	

Në KRU "Hidromorava" SH.A. kompensimet për drejtorët, që nga fillimi i emërimit të Bordit të Drejtorëve e deri me rastin e raportimit, janë bërë konform Vendimit Nr. 07/81 të datës: 23.03.2016 - mbi lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore sipas kategorizimit të vendosur nga Aksionari - Qeveria e Kosovës.

## 2.5. Numri i takimeve të Bordit gjatë vitit dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e Bordit

Gjatë vitit 2025, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe kryerjes së detyrave të tyre në mënyrë sa më efektive, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur dymbëdhjetë (12) mbledhje të rregullta. Pjesëmarrja e drejtorëve ka qenë pothuajse e plotë gjatë gjithë këtyre takimeve, pra gjatë këtyre takimeve të Bordit të Drejtorëve gjithmonë ka pasur kuorum të nevojshëm për vendimmarrje.

## 2.6. Komisionet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura

Ministria e Ekonomisë, me Vendimin nr. 563 të datës: 17.03.2022, e cakton Komisionin e Auditimit në kuadër të Bordit të Drejtorëve në përbërje prej:

- Znj. Ferdane Tahiri Sylejmani - Kryesuese e Komisionit të Auditimit;
- Znj. Lindita Fazliu - anëtare e Komisionit të Auditimit;
- Znj. Filloretë Gashi Sadiku - anëtare e Komisionit.

Pasi sipas Ligjit të Ndërmarrjeve Publike, Kryesuesi i Bordit nuk lejohet të jetë pjesë e Komisionit të Auditimit, pas Vendimit Nr. 03/173 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/67 të datës 9 mars 2022 për emërimin e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, znj. Filloretë Gashi Sadiku që nga data: 16 nëntor 2023 me automatizëm konsiderohet që nuk është më pjesë e Komisionit të Auditimit.

Ministria e Ekonomisë, me datë 22.01.2025, në mbështetje të neneve 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe të nenit 14 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Shtojca 1.13 së Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e

<sup>1</sup> Znj. Filloretë Gashi Sadiku ka ushtruar pozitën e Kryesueses së Bordit të Drejtorëve deri më datë 24.03.2025, datë në të cilën ka paraqitur dorëheqjen e saj nga kjo pozitë.

<sup>2</sup> Deri më datë 21.05.2025, ndërsa nga kjo datë kompensimi është 450 €, bazuar në Vendimin e Ministrisë së Ekonomisë për caktimin në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.

<sup>3</sup> Bazuar në Vendimin e Ministrisë së Ekonomisë për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për emërimin e Komisionit të Auditimit në KRU "Hidromorava" Sh.A. me nr. 201 (protokolli i ME) i dt. 22.01.2025.

përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, ka marrë Vendimin nr. 201 (protokoll i ME), të datës 22.01.2025, për caktimin e:

➤ Z. Arban Hoxha - anëtar i Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2025 ka mbajtur shtatë (7) mbledhje të rregullta, gjatë të cilave janë shqyrtuar çështje thelbësore të afarizmit të Ndërmarrjes, para shqyrtimit dhe miratimit të tyre nga Bordi i Drejtorëve.

Gjatë këtij viti, Komisioni i Auditimit ka zhvilluar procedurat e rekrutimit në përputhje me Konkursin Publik (rishpallje e konkursit) me nr. të referencës 1838, të publikuar më datë 31.12.2024, për pozitën Zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A. Procedura e rekrutimit dhe vlerësimit është përfunduar me sukses dhe, me Vendimin nr. 134 të datës 13.02.2025, është përzgjedhur kandidati i suksesshëm.

Në mbledhjen e dytë të rregullt, të mbajtur më datë 28.02.2025, Komisioni i Auditimit, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara në dispozitat ligjore të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, konkretisht në nenin 21, i cili përcakton kompetencat e Komisionit të Auditimit, ka marrë Vendimin nr. 182 të datës 28.02.2025 për emërimin e

➤ z. Avdyl Kastrati - Zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A.

Komisioni i Auditimit ka zhvilluar një punë të vazhdueshme dhe me rëndësi të veçantë gjatë vitit 2025, duke kontribuar në forcimin e transparencës dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve dhe proceseve financiare.

Përveç shqyrtimit të raporteve të auditimit, Komisioni ka shqyrtuar edhe Raportin njëvjeçar të punës për vitin 2024, i cili ofron një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura gjatë vitit, si dhe Raportet tremujore operative dhe financiare. Këto raporte kanë shërbyer si burim i rëndësishëm informacioni për monitorimin e performancës dhe për identifikimin e mundësive për përmirësimin e menaxhimit të brendshëm dhe alokimit të burimeve financiare.

Një element i rëndësishëm i punës së Komisionit ka qenë edhe ofrimi i rekomandimeve për Menaxhmentin e KRU "Hidromorava" Sh.A., si dhe për Zyrën e Prokurimit, me qëllim që proceset dhe procedurat të jenë të drejta, transparente dhe në përputhje me legjislacionin dhe politikat në fuqi. Rekomandimet e Komisionit kanë kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të operacioneve të kompanisë, si dhe në përmirësimin e proceseve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.

Komisioni i Auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe në bazë të rekomandimeve të Zyrës së Auditimit të Brendshëm, gjatë vitit 2025 unanimisht ka miratuar raportet dhe dokumentet si në vijim:

1. Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 i KRU "Hidromorava" Sh.A.
2. Raporti Final i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit "Kyçjet individuale për fshatrat Muçivërc, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët dhe Roganë - Komuna e Kamenicës", KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 01/2025.
3. Raporti Final i Auditimit - "Auditimi i shpenzimeve për mallra, shërbime dhe komunalie", KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 02/2025.
4. Raporti i Auditimit mbi ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit dhe kalimin e kyçjeve individuale të konsumatorëve nga gypat AC në gypa HDPE në qytetin e Vitisë, për Situacionin e dytë (II) të përkohshëm të punëve të kryera, KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 03/2025.
5. Raporti Final i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit të furnizimit me ujëmatës, bllokues dhe plomba

- për ujëmatës, KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 04/2025.
6. Raporti Final i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit "Kyçjet individuale në fshatin Uglar - Komuna e Gjilanit", KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 05/2025.
  7. Plani Strategjik i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026-2028, KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 06/2025.
  8. Plani Vjetor i Punës për Zyrën e Auditimit të Brendshëm për vitin 2026, KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, Nr. 07/2025.
  9. Raporti Final i Auditimit - Auditimi i të hyrave: inkasimi nga shërbimet e ujit dhe kanalizimit, si dhe shërbimet e tjera, KRU "Hidromorava" Sh.A., Nr. 08/2025.

Raportet e lartcekura përfaqësojnë rezultatet e punës auditimore për periudhën përkatëse dhe janë përgatitur në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, standardet profesionale të auditimit të brendshëm dhe praktikatat e mira të qeverisjes korporative. Këto raporte i paraqiten Bordit të Drejtorëve për shqyrtim dhe aprovim, në përputhje me procedurat e brendshme të Ndërmarrjes.

**Shënim:** Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" Sh.A., edhe gjatë vitit 2025 nuk e ka vlerësuar si të nevojshme themelimin e komisioneve të tjera, qoftë të përkohshme apo të përhershme.



## 3. KRYESHEFI EKZEKUTIV

### 3.1. Aktivitetet kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv

Raporti i përket periudhës raportuese të vitit 2025 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidromorava" - Sh.A. Gjilan. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kryeshefi Ekzekutiv është fokusuar që t'i tejkalojë sfidat kryesore për Ndërmarrjen të cilat kanë qenë dhe mbeten:

- **Dalja në treg të lirë për furnizim me energji elektrike:** Sfidë e madhe për kompaninë mbetet dalja në treg të lirë për furnizim me energji nga data 1 qershor 2025, pasi që faturat e energjisë për muajt qershor - nëntor 2025 kanë ngritje mbi 100% dhe këto shpenzime nuk janë të parapara në PB 2025 si dhe nuk janë të parapara as në proces tarifor 2025 që d.m.th. se nuk ka pas ngritje të tarifës për këtë shpenzim, pasi që edhe ARRU nuk ka pasur informata se një gjë e tillë do të ndodh në mes të vitit 2025. Ne kemi pasur disa takime me ARRU, ku të njëjtit kanë pasur takime me ZRRE me kërkesë që për ujësjetës të ketë përjashtim nga dalja në treg të lirë, por që përgjigja e ZRRE ka qenë negative dhe se sipas ligjit edhe NP duhet ti nënshtrohen daljes në treg të lirë. Gjithashtu, ne kemi dërguar kërkesë edhe në ARRU që të ketë proces të jashtëzakonshëm për ngritje të tarifës së ujit, por që të njëjtit na kanë kthyer përgjigje zyrtare se është e pamundur të ketë një proces të jashtëzakonshëm tarifor për shkak të kohës së shkurt, si dhe ARRU në këtë kohë veç se janë duke punuar në një proces të rregullt tarifor 3 vjeçar 2026-2028. Sipas letrës së tyre, kosto më e madhe për energji që do të shpenzohet gjatë këtyre 7 muajve të vitit 2025 do të përlllogaritet në procesin tarifor 2026-2028. Ky shpenzim i pa parashikuar do të ndikoj edhe në pasqyrën e të ardhurave të Kompanisë me theks të veçantë të fitimi/humbja NETO, pas zhvlerësimit dhe pas provizionimit (zëra jo material).
- **Menaxhimi i prodhimit dhe furnizimi me ujë:** Gjatë muajve të verës, një sfidë e madhe për Ndërmarrjen ka qenë furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët, por që ia kemi dal me sukses të plotësojmë kërkesat e shtuara gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të disa lagjeve që gjenden në lartësi më të madhe, ku kemi pasur mungesa të kohëpaskohshme të furnizimit. Edhe në muajin dhjetor 2025, e sidomos në gjysmën e dytë të dhjetorit kemi pas kërkesë të shtuar për furnizim me ujë, pasi që kemi pas një fluks të madh të mërgimtarëve, por që kemi arrit të kemi një furnizim shumë të mirë dhe pothuajse pa ankesa nga konsumatorët.
- **Menaxhimi i humbjeve të ujit:** Mbetet një sfidë e vazhdueshme për Kompaninë dhe për të ardhur deri të rezultatet e dukshme nevojiten investime, si në rrjet të ujësjetës, po ashtu edhe në ndërrim të ujëmatësve të vjetër, në krijimin e DMA zonave të reja, në vendosjen e pajisjeve për menaxhim të presionit etj., të cilat i kemi parapa në investime në Planin e Biznesit 2026-2028. Përveç humbjeve teknike, nevojitet një fokus i madh në humbjet komerciale, në luftimin e keqpërdoruesve të ujit përmes lidhjeve ilegale, për çka edhe kemi parapa një ekip të veçantë për këtë aktivitet, në punëtorin e fundit me Bordin e Drejtorëve, me që rast edhe i kemi parapa ndryshimet në "Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës".
- **Inkasimi i borxheve të vjetra:** Mbetet sfidë e vazhdueshme pasi që kemi të bëjmë me një kategori të konsumatorëve që nuk kanë paguar për një kohë të gjatë dhe është e vështirë që të binden për pagesë, pasi që edhe ligji për marrëdhëniet detyrimore e lejon parashkrimin e borxheve më të vjetra se një vit. Në këtë aspekt jemi duke e zbatuar "Planin e Veprimt"

për vitin 2025 dhe përveç aktiviteteve të zakonshme kemi filluar edhe vizitat me prezencë të policisë të konsumatorëve të cilët nuk kanë lejuar shkyçjen nga rrjeti i ujësjellësit për shkak të borxheve të pa paguara.

- **Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Fabrikave të Prodhimit (Përlepnice, Velekincë dhe Letnicë)** – Është një sfidë e madhe për Kompaninë, pasi që në këto fabrika pothuajse nuk është investuar fare për një kohë të gjatë, si dhe nuk ka pas mirëmbajtje të rregullt të tyre. Në fabrikën në Përlepnice përveç që ka munguar mirëmbajtja e rregullt, nuk ka pasur as investime që nga viti 2004, në Fabrikën në Velekincë po ashtu nuk ka pasur mirëmbajtje të rregullt dhe investime që nga viti 2014 (me përjashtim të një investimi të vogël për mirëmbajtje në vlerë prej 150,000.00€ nga Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2024), në Fabrikën në Letnicë gjithashtu nuk ka pasur investime e as mirëmbajtje të rregullt që nga lëshimi në punë i fabrikës në vitin 2002). Duke marr parasysh tarifën e ulët, të ndikuara edhe nga inflacioni i 3 viteve të fundit, e në anën tjetër koston e lartë për të investuar në fabrika, ka qenë pothuajse e pamundur që ky investim të bëhet me mjete vetanake deri më tani, por me ngritjen e tarifave, nga viti 2026 e tutje, duhet ti japim prioritet investimeve në fabrika me pajisje të teknologjisë së re dhe pastaj të ketë edhe mirëmbajtje të rregullt të tyre.
- **Menaxhimi i projekteve të shumta paralele: Sfiduese mbetet edhe menaxhimi efikas i një numri të madh të projekteve** – si ato të financuara nga të hyrat e Kompanisë, projektet me Ministrinë e Ekonomisë, si dhe projektet në bashkëpunim me Bankën Botërore në kuadër të programit FLOWS, i cili tashmë ka hyrë në fazën e zbatimit në terren me PAKO-n 1 dhe PAKO-n 2, si dhe projekti me EBRD dhe EIB për ITUN, ku pas nënshkrimit të dy Marrëveshjeve, asaj për ndërtim të kolektorëve në gjatësi prej 12.5 km, si dhe Kompanisë Mbikëqyrëse për mbikëqyrje të punimeve, shumë shpejt pritet edhe të fillohet me punët në terren.

Përkundër këtyre sfidave, Ndërmarrja mbetet e përkushtuar në zbatimin e masave konkrete për përmirësimin e funksionimit operativ dhe garantimin e furnizimit cilësor me ujë për të gjithë konsumatorët.

### 3.2. Aktivitetet e tjera të Kryeshefit Ekzekutiv

Gjatë vitit 2025, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidromorava" Sh.A. ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe takimesh zyrtare me institucione qendrore dhe lokale, organizata ndërkombëtare, donatorë, operatorë ekonomikë, si dhe me përfaqësues të shoqatave profesionale të sektorit të ujit. Këto aktivitete kanë pasur për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, sigurimin e mbështetjes financiare dhe teknike për projekte strategjike, si dhe rritjen e efikasitetit operativ dhe menaxherial të Ndërmarrjes.

Një pjesë e rëndësishme e angazhimeve ka qenë e orientuar në koordinimin me komunat ku KRU "Hidromorava" Sh.A. ofron shërbime, përkatësisht Komunën e Gjilanit, Komunën e Kamenicës, Komunën e Vitisë dhe Komunën e Klllokotit, me fokus në menaxhimin e projekteve infrastrukturore të ujësjellësit dhe kanalizimit, bashkërendimin e punimeve në terren, marrjen nën menaxhim të sistemeve ekzistuese të ujësjellësit, si dhe adresimin e çështjeve që ndërlidhen me furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm, veçanërisht gjatë sezonit veror dhe periudhave me kërkesë të shtuar.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe rregullatore, Kryeshefi Ekzekutiv ka marrë pjesë në takime të rregullta me Ministrinë e Ekonomisë, ARRU-në, MMPHI-në dhe ZRRE-në, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme që ndërlidhen me procesin tarifor për periudhën 2026–2028, ndikimin e daljes së obliguar të KRU-ve në tregun e lirë të energjisë elektrike, pajisjen me leje ujore, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të

Jashtëm. Këto takime kanë qenë thelbësore për përgatitjen e Ndërmarrjes ndaj ndryshimeve rregullatore dhe financiare që ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e saj.

Shpenzimet nga gjobat dhe ndëshkimet	0.00		55,297.00		-55,297.00
Shpenzimet e borxhit të keq <sup>21</sup>	18,078.00		23,140.08		-5,062.08
Provizionimi i borxhit të keq <sup>22</sup>	12,755.49		18,222.13		-5,466.64
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>3,948,103.49</b>		<b>2,932,681.13</b>		<b>311,635.28</b>


<sup>21</sup> Sqarim lidhur me shpenzimin e borxhit të keq për vitin 2025 në vlerë prej 18,078.00 €, i cili ka rezultuar nga parashkrimi i borxheve për të cilët vendimi gjyqësor ka konstatuar se borxhet nuk janë të arkëtueshme për shkak të parashkrimit ligjor ose arsyeve të tjera juridike.

<sup>22</sup> Provizionimi i borxheve është miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

### 5.17. Konsumatorë të regjistruar

Konsumatorët e regjistruar në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 janë shtuar për 3,348, ndërsa krahasuar me planin janë 3,328 konsumatorë me shumë.


Grafiku 9. Konsumator të regjistruar



### 5.18. Konsumatorët aktivë me ujëmatës

Konsumatorët aktiv me ujëmatës gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024 janë shtuar për 3,206, ndërsa në krahasim me planin janë 1,788 konsumatorë me shumë.


Grafiku 10. Konsumatorë aktivë me ujëmatës



### 5.19. Konsumatorët pa ujëmatës

Konsumatorët pa ujëmatës gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024 janë rritur për 25 konsumatorë, ndërsa në raport me planin nuk kemi arritur të përmbushim cakun në montimin e ujëmatësve.


Grafiku 11. Konsumatorët pa ujëmatës



### 5.20. Numri i konsumatorëve aktivë

Konsumatorët aktivë në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 janë shtuar për 3,226 konsumatorë, ndërsa në raport me planin janë më tepër për 1,814.


Grafiku 12. Numri i konsumatorëve aktivë



### 5.21. Faturimi i ujit me ujëmatës

Faturimi i ujit me ujëmatës në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 është më i ulët për 115,858 m<sup>3</sup><sup>23</sup>, ndërsa planin nuk e kemi realizuar për 965,089 m<sup>3</sup>.

Grafiku 13. Faturimi i ujit me ujëmatës (m<sup>3</sup>)




### 5.22. Investimet vetanake

Përmes investimeve vetanake, gjatë vitit 2025 janë realizuar investime në vlerë prej 453,427.14 €. Krahasuar me vitin 2024, kur vlera e investimeve ishte 482,529.00 €, vërehet një ulje prej 29,101.86 €, respektivisht rreth 6.0%.

Kjo rënie është kryesisht rezultat i përfundimit të disa projekteve investive gjatë vitit 2024, si dhe orientimit të ndërmarrjes drejt konsolidimit të investimeve ekzistuese dhe optimizimit të shpenzimeve, duke u fokusuar në mirëmbajtje dhe rritje të efikasitetit operacional.

Grafiku 14. Investimet vetanake



<sup>23</sup> Mosrealizimi i planit për faturimin e ujit ka ardhur si rezultat i sfidave të njohura në uljen e humbjeve në shkallën e parashikuar. Si Ndërmarrje, kemi qenë të vetëdijshëm për vështirësitë e arritjes së këtij objekti, mirëpo ky cak është përcaktuar nga Autoriteti Rregullator në procesin e kaluar tarifor. Në këtë proces, sasia e faturimit është një faktor që ndikon drejtpërdrejtë në përcaktimin e çmimit të tarifës së ujit, dhe si rrjedhojë ne e kemi pranuar këtë objektiv si pjesë të procesit rregullator.

## 6. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS VJETORE PËR 2025 NGA DEPARTAMENTI FINANCIAR

Gjatë vitit raportues 2025, Ndërmarrja ka vijuar përpjekjet për përmirësimin e performancës operationale dhe financiare, me fokus në menaxhimin sa më efikas të burimeve dhe kontrollin e shpenzimeve. Megjithatë, krahasuar me vitin 2024, është evidentuar një rritje e shpenzimeve operative, e shkaktuar kryesisht nga rritja e kostove të energjisë elektrike, si dhe nga shtimi i numrit të stafit, i cili ka qenë i nevojshëm për përmbushjen e kërkesave operative dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve.

Faturimi i ujit nuk ka arritur nivelin e planifikuar për shkak të objektivave sfiduese të përcaktuara nga Autoriteti Rregullator në procesin tarifor. Megjithatë, Ndërmarrja ka pranuar këtë proces si pjesë të kornizës rregullatore dhe ka vazhduar përpjekjet për të përmbushur objektivat.

Në aspektin investiv, Ndërmarrja ka realizuar me mjete vetanake projekte kyçe për përmirësimin e kapacitetit të furnizimit me ujë dhe infrastrukturës së rrjetit. Edhe pse këto projekte ende nuk janë përfunduar, angazhimi për realizimin e tyre do të ketë ndikim pozitiv në cilësinë e shërbimit dhe efikasitetin operativ në të ardhmen.

Në përfundim, pavarësisht sfidave dhe faktorëve të jashtëm, Ndërmarrja ka demonstruar stabilitet dhe përkushtim ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve të saj, duke synuar të përmbushë pritshmëritë e autoriteteve rregullatore dhe konsumatorëve.



## 7. RAPORTI I ZYRËS SË PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2025 ka pranuar disa kërkesa me shkrim, për furnizime, shërbime dhe punë, nga njësitë përkatëse të cilat janë inicuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, ku këto kërkesa pastaj janë proceduar varësisht prej prioriteteve dhe konform rregullave të prokurimit.

Tabela 16. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2025 - "vlerë minimale"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
27.02.2025	Furnizim me pajisje të ndryshme për punëtorët e KRU Hidromorava	"EUROTEC" Sh.P.K.	989.20 €
10.04.2025	Rregullimi i dy automjeteve të rënda	"Xhafer R. Musliu" B.I.	965.00 €
20.05.2025	Furnizim me fatura për konsumatorë dhe fasiklla varëse	"Pika 5A" Sh.A.	990.00 €
31.07.2025	Furnizim me akumulator për makinerinë e Ndërmarrjes dhe rregullimi i automjeteve Toyota dhe Caddy	"UNIVERSAL" Sh.P.K.	880.00 €
04.08.2025	Furnizim me fatura për konsumatorë	"PIKA 5A" Sh.P.K.	495.00 €
14.08.2025	Furnizim me gyp për kamionet të kanalizimit	"Gazmend Bojku" B.I.	988.80€
07.10.2025	Rregullimi i kombit të kanalizimit për Nj.O. në Viti	"UNIVERSAL" Sh.P.K.	998.50 €
03.11.2025	Furnizim me pajisje për stacionin e pompave në fshatin Bilinicë	"Linda SPA" Sh.P.K.	620.00 €
26.12.2025	Servisimi i automjeteve të vogla dhe furnizim me goma për automjetet e KRU "Hidromorava" Sh.A.	"Universal" Sh.P.K	987.00 €
25.12.2025	Kalibrimi i pajisjeve laboratorike	"Flamur Isufi" B.I.	846.00 €

Tabela 17. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2025 - "procedurë e hapur - kuotim i çmimit"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Shuma
23.01.2025	Furnizim me pajisje për ndriçim	"BAK - ING" SH.P.K.	2,188.48€
03.02.2025	Furnizim me pajisje elektrike	"Panamic ICT" L.L.C.	5,780.00 €
04.04.2025	Furnizim me reagjentë kimik	"Interlab" Sh.P.K.	7,430.00€
25.04.2025	Furnizimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë në porto arka	"FATI SECURITY" Sh.P.K.	817.00€

26.06.2025	Servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrit si dhe blerje të reja	"Murat Abazi" B.I.	961.00 €
09.09.2025	Riparimi i gjeneratorit elektrik në FPU Përlepnice	"Power System" Sh.P.K.	8,220.00€
09.09.2025	Furnizimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë në zyrën qendrore, FPU Letnicë dhe Guri i Hoxhës	"Fati Security" Sh.P.K.	2,606.00€
04.09.2025	Furnizim dhe Instalim me Kondicioner Inverter	"Infinit" Sh.P.K.	2,235.00€
07.10.2025	Rishikim i Pasqyrave Financiare për nevoja të palëve të treta	"NEXIA KOSOVA AUDIT" L.L.C.	1,920.00 €
19.11.2025	Furnizim me aktuatorë	NOVAMAT Sh.P.K	8.200,00€
27.11.2025	Mirëmbajtja e licencës së "Firewallit Fortinet" për periudhë tre vjeçare	Safebit L.L.C.	1.790,00€
08.12.2025	Microsoft Office 365 Exchange 45 user <sup>24</sup>	"Cactus" Sh.A.	2,973.60 €
12.12.2025	Furnizim me kompjuterë dhe lllaptop	"ARITECH" Sh.P.K.	3,139.00 €
27.11.2025	Furnizim me elektropompa	N.P.Sh."HITERM EL"	60,000.00€
20.11.2025	Kyçjet individuale në Fshatin Uglar - ritender	Grup i Operatorëve Ekonomik "GJIKURIA"; "DIAMANTI" Sh.P.K.; "Hidro Mentori" Sh.P.K.	60,602.50€

Tabela 18. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2025 - "vlerë e madhe"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Shuma
16.10.2025	Furnizimi me ujëmatës, bllokues dhe pllomba për ujëmatës	"X" Sh.P.K.	195,125.00 €

Tabela 19. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2025 - "procedurë e hapur - vlerë e mesme"


Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Shuma
12.03.2025	Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE.	K.N.T.SH. Teuta - M Sh.P.K.	257,080.79€

<sup>24</sup> Licenca e cila përdoret për e-mail adresat zyrtare.

25.04.2025	Kyçjet (e rrugëve apo shtëpive individuale përgjatë kolektorit fshati Livoç i Epërm - Livoç i Ulët - Kodra e Thatë, gjatësi 800m)	"Eng Bau" Sh.P.K.	32,476.00€
08.05.2025	Furnizim me kimikate dhe bombola të zbrazëta	"Seykos" Sh.P.K.	56,350.00€
18.06.2025	Ndërtimi dhe rehabilitimi i rezervuarave në Kamenicë	K.N.T.Sh. "Teuta - M" Sh.P.K.	120,021.85€
14.08.2025	Ndërimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në Rr. "Abdullah Tahiri" me gjatësi L=450m - ri tender	Grup i Operatorëve Ekonomik "KUSHTRIMI NM" Sh.P.K. dhe "ENGINEERING RK" Sh .P.K.	57,900.00 €
08.10.2025	Furnizim me material administrativ	"Offishop Group" Sh.P.K.	12,000.00 €
02.10.2025	Furnizim me ujëmatës	"X" Sh.P.K.	47,475.00 €
03.12.2025	Servisimi i makinerisë së rëndë	"Auto Ballkan Group" Sh.P.K.	20,000.00 €
17.12.2025	Furnizim me automjet (veturë) për bartjen e punëtorëve për ekipet e ujësjellësit 4x4	Auto Salloni "Erini" Sh.P.K.	43,930,00 €

Tabela 20. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2025 - "Aneks Kontratë"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Shuma
02.04.2025	Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjës së puseve dhe ndërtimit të rrjetit në Berivojë - Aneks Kontratë	Grup i Operatorëve Ekonomik "Cubic Group" Sh.P.K.; NNT ABC Sh.P.K.	12,504.00€



## 8. RAPORTI I DIVISIONIT PËR CILËSINË E UJIT

### 8.1. Cilësia e ujit

Raporti i vitit 2025 jep një pasqyrë të përmblodhur të cilësisë së ujit të pijshëm nëpër të gjitha zonat e KRU "Hidromorava" Sh.A. Bazuar në rezultatet e analizave fiziko - kimike dhe mikrobiologjike të punuara në laboratorin qendror të KRU "Hidromorava", në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan - QRSHP si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - IKSHPK, cilësia e ujit për periudhën raportuese është rreth 99% në përputhje me vlerat parametrike për ujën e pijshëm.

Duke u bazuar në Planin për Monitorim të Cilësisë së Ujit, në KRU "Hidromorava", monitorimi i cilësisë së ujit bëhet nëpërmjet dhjetë zonave të ndara sipas karakteristikave të ujit.

1. **Zona HM 01**- burimi "Guri i Hoxhës" dhe "Liqeni i Përlepnicës", kjo është zona më e madhe në KRU "Hidromorava";
2. **Zona HM 02** - burimet e ujit në "Pasjan", "Fabrika e Përpunimit të Ujit në Velekincë";
3. **Zona HM 03** - burimi "Baja";
4. **Zona HM 04** - zonat rurale (burimet e ujit në Malishevë, Zhegër, Doberqan, Llovçë dhe Bilinicë);
5. **Zona HM 05** - Letnica, Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë;
6. **Zona HM 06** - burimet e ujit në fshatin Pozharan;
7. **Zona HM 07** - burimet e ujit në Kamenicë, fshatin Karaçevë dhe Shipashnicë;
8. **Zona HM 08** - burimet e ujit në fshatin Topanicë dhe Koretin;
9. **Zona HM 09** - burimet e ujit në fshatin Makresh, Novoberdë;
10. **Zona HM 10** - burimet e ujit në Ranillug dhe fshatin Ropotovë.

Tabela 21. Analizat e cilësisë së ujit gjatë vitit 2025

Lloji i analizave	Mostrat e punuara	Mostrat që nuk janë përputhur me vlerat parametrike
Fiziko - kimike	2,472	17
Mikrobiologjike	345	13
Metalet e rënda	39	0

- **Parametrat fizik të cilët janë punuar janë:** era, ngjyra, shija, përqeshmëria elektrike, turbullira, fortësia e ujit.
- **Parametrat kimik të cilët janë punuar janë:** pH, klori residual, amoniaku, nitritet, nitratet, sulfatet, hekuri, mangani, kalciumi, magnezi, shpenzimi i KMnO<sub>4</sub>, fosfatet, kloruret, alumini.
- **Parametrat mikrobiologjik të cilët janë punuar janë:**

1. Numri i tërësishëm i baktereve koliforme në 100 ml;
2. Bakteret koliforme me prejardhje fekale në 100 ml;
3. Numri i tërësishëm i baktereve të gjalla në 37 gradë Celsius;
4. Streptokoket me prejardhje fekale në 100 m.

Shpeshësia e marrjes së mostrave është përcaktuar në bazë të kapacitetit të furnizimit me ujë dhe numrit të banorëve për secilën zonë të shërbimit. Parametrat janë të ndarë në grupet A dhe B dhe janë analizuar si pas trajtimit të ujit, ashtu edhe në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me Planin e Monitorimit të Cilësisë së Ujit, të aprovuar nga autoritetet kompetente.

Gjatë vitit 2025, për shkak të reshjeve të shumta dhe vërshimeve të theksuara, janë evidentuar probleme të përkohshme në cilësinë e ujit në disa burime vetanake, si pasojë e ndikimit të faktorëve hidrometeorologjikë. Megjithatë, në Impiantet e Trajtimit të Ujit (ITU) situata është menaxhuar në mënyrë të kontrolluar dhe profesionale, duke garantuar në pjesën më të madhe vazhdimësinë e furnizimit dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë së ujit.

Përrjashtim ka qenë Impianti i Trajtimit të Ujit në Letnicë, ku për një (1) ditë është shënuar ndërprerje e prodhimit të ujit, për shkak të pamundësisë teknike për trajtimin e ujit të papërpunuar, si rezultat i ngarkesës së lartë dhe cilësisë së papërshtatshme të tij. Për të gjitha situatat e krijuara, konsumatorët janë njoftuar me kohë dhe në mënyrë transparente përmes faqeve zyrtare të KRU "Hidromorava" Sh.A., në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat e informimit publik. Vlen të theksohet se të gjitha mostrat e raportuara janë analizuar në laboratorin e KRU "Hidromorava" Sh.A., i cili është i akredituar sipas standardit ISO/IEC 17025, si dhe në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik dhe IKSHPK.

Mos-përputhjet e konstatuara me vlerat standarde kanë qenë të natyrës së kufizuar dhe kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e klorit të lirë rezidual, rritje të lehtë të turbullirës, nitrateve si dhe prezencën e manganit në disa mostra uji.




## 9. RAPORT I PUNËS SË DEPARTAMENTIT TEKNIK

### 9.1. Divizioni për prodhimin, impiantet e ujit dhe stacionet e pompimit

#### 9.1.1. Furnizimi me ujë

Kapacitetet e ujit në burimet kryesore që menaxhohen nga KRU "Hidromorava" brenda vitit 2025 kanë variuar në varësi të periudhës kohore, kërkesës për ujë nga konsumatorët por edhe prej situatës meteorologjike që ka mbretëruar në rajonin tonë. Siç shihet nga Grafiku 16, gjatë muajit janar 2025 niveli i ujit në akumulacionin e Përlepnicës, që njëherësh është edhe burimi kryesor për KRU "Hidromorava", ka qenë në kuotën 25.30. Gjatë muajit korrik të vitit 2025, niveli i ujit ka qenë në kuotën 27.74, ndërsa në mungesë të reshjeve intensive në fund të vitit 2025, deri në muajin nëntor ka pasur rënie të nivelit e që në fund të muajit nëntor ka ra niveli në 21.14. Por me fillimin e reshjeve në fund të muajit dhjetor ka arritur niveli në vlerën maksimale 30.3.

Grafiku 15. Niveli i ujit në akumulacionin e Përlepnicës gjatë vitit 2025



Për ta menaxhuar situatën, në vazhdimësi është përcjellë gjendja, duke u bazuar edhe në planin për menaxhimin e thatësisrës dhe duke reaguar me kohë me masat e nevojshme. Për shkak të kësaj situatë dhe me qëllim të ruajtjes së kapaciteteve ekzistuese të ujit nga fillimi i muajit shtator është zbatuar kufizimi i furnizimit me ujë nga FPU në Përlepnicë nga ora 24:00 deri në 05:00 të mëngjesit, duke e zvogëluar sasinë e ujit në 200m<sup>3</sup> dhe ka vazhduar furnizimi me ujë nga burimi "Guri i Hoxhës".

Kjo masë ka ndikuar dukshëm në menaxhimin e situatës dhe balancimin e ujit të prodhuar dhe kërkesës për ujë nga konsumatorët.

Tabela 22. Vëllimi i ujit në varësi të nivelit të ujit në akumulacion gjatë vitit 2025

Muaji /2025	Niveli -m	Vëllimi në m <sup>3</sup>	Vëllimi i vdekur në m <sup>3</sup>	Vëllimi i mbetur për shfrytëzim në m <sup>3</sup>	Vëllimi maksimal i shfrytëzuar në m <sup>3</sup>	Sasia e munguar e ujit në m <sup>3</sup>
Janar	24,76	3,268,646,86	455,000.0	2,813,646,86	3,545,000,00	731353,14
Shkurt	25,20	3,326,732,67	455,000.0	2871,732,67	3,545,000,00	673,267,33
Mars	25,50	3,366,336,63	455,000.0	2,911,336,63	3,545,000,00	633,663,37
Prill	26,00	3,432,343,23	455,000.0	2,977,343,23	3,545,000,00	567,656,77
Maj	29,84	3,939,273,92	455,000.0	3,484,273,92	3,545,000,00	60,726,08
Qershor	29,44	3,886,468,64	455,000.0	3,431,468,64	3,545,000,00	113,531,36
Korrik	27,74	3,662,046,20	455,000.0	3,207,046,20	3,545,000,00	337,953,80
Gusht	25,58	3,376,897,68	455,000.0	2,921,897,68	3,545,000,00	623,102,32
Shtator	23,70	3,128,712,86	455,000.0	2,673,712,86	3,545,000,00	871,287,14
Tetor	21,90	2,891,089,10	455,000.0	2,436,089,10	3,545,000,00	1,108,910,90
Nëntor	21,14	2,790,759,07	455,000.0	2,335,759,07	3,545,000,00	1,209,240,93
Dhjetor	30,30	4,000,000,00	455,000.0	3,545,000,00	3,545,000,00	0,00

### 9.1.2. Prodhimi, faturimi dhe UPF i ujit në KRU "Hidromorava" - Sh.A.

Në pikat e tjera të burimeve të ujit gjatë vitit 2025 situata me kapacitete të prodhimit të ujit ka qenë e mirë, duke përfshirë njësitë operative në Viti dhe Kamenicë.

Prodhimi i ujit gjatë vitit 2025, si çdo vit tjetër, ka qenë i koordinuar me kërkesën për ujë nga konsumatorët. Natyrisht, të gjitha pikat e prodhimit janë përballur herë pas here me probleme të ndryshme, siç janë: defektet në pompa, defektet në dhomat komanduese dhe në sistemet e komunikimit, si dhe në sistemet e klorimit. Përkundër këtyre vështirësive, të gjitha defektet janë evituar në kohë optimale, duke bërë të mundur që prodhimi i ujit për konsumatorët të jetë konstant dhe pa ndërprerje.

Prodhimi i ujit në vitin 2025 ka qenë 9,207,357 m<sup>3</sup>, ndërsa në vitin 2024 ka qenë 9,087,374 m<sup>3</sup>. Kjo rritje ka ndodhur si rezultat i futjes në operim të sistemit të pompimit nr. 6 (Berivojca) në Kamenicë, nga muaji maj 2025, si dhe marrjes në menaxhim të gjashtë fshatrave të Komunës së Kamenicës (Muçivercë, Dajkoc, Novosellë, Hodonovcë, Roganë dhe Shipashnicë e Poshtme) nga muaji nëntor 2025. Prodhimi i ujit për këto dy sisteme gjatë vitit 2025 ka qenë 154,179 m<sup>3</sup>.

Në vazhdim paraqitet prodhimi i ujit sipas burimeve të ujit, i ilustruar përmes grafikoni.

Grafiku 16. Prodhimi i ujit sipas burimeve gjatë vitit 2025



### 9.1.3. Uji i pafaturuar (UPF)


Zvogëlimi i humbjeve të ujit (UPF) paraqet padyshim një nga sfidat më të mëdha për Ndërmarrjen tonë, për faktin se 54.2% e ujit të trajtuar nuk arrin të faturohet, si pasojë e humbjeve fizike (rrjedhjet nga gypat), ashtu edhe e humbjeve komerciale (gabimet në matje dhe lexim, keqpërdorimet, vjedhjet, etj.). Shkalla e lartë e humbjeve të ujit jo vetëm që shkakton humbje substanciale financiare për ndërmarrjen, por ndikon drejtpërdrejt edhe në cilësinë e furnizimit të konsumatorëve, duke shkaktuar ndërprerje në furnizim. Si pasojë, rrezikohet cilësia e ujit dhe, rrjedhimisht, paraqitet një kërcënim i vazhdueshëm për shëndetin e qytetarëve.

Tabela 23. Të dhënat e paraqitura për UPF-në, në nivel regjioni për vitin - 2025

Njësia	Prodhimi i ujit ( m <sup>3</sup> )	Faturimi i ujit (m <sup>3</sup> )	Uji i pafaturuar (m <sup>3</sup> )	UPF (%)
Gjilan	6,448,576	3,203,700	3,244,876	50.32
Viti	1,656,950	486,542	1,170,408	70.64
Kamenicë	988,133	492,137	495,996	50.20
Ranillug	67,191	40,082	27,109	40.35
Novobërdë	57,176	11,252	45,924	80.32

Partesh	52,331	9,086	43,245	82.64
<b>Totali</b>	<b>9,270,357</b>	<b>4,242,799</b>	<b>5,027,558</b>	<b>54.23</b>

Grafiku 17. UPF gjatë vitit 2025



**Shënim plotësues:** Duke marrë parasysh se në të ardhmen janë planifikuar investime në KRU "Hidromorava" përmes projektit FLOWS, i financuar nga Banka Botërore, pritet që të ketë përmirësim të furnizimit me ujë dhe, rrjedhimisht, rritje të faturimit.

## 9.2. Divizioni i rrjetit të ujësjellësit

### 9.2.1 Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit

Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit edhe gjatë këtij viti ka qenë sfiduese, për shkak të amortizimit të rrjetit, i cili ka shkaktuar defekte të vazhdueshme në rrjetin e ujësjellësit. Këto defekte janë evituar në kohën më të shkurtër të mundshme, duke respektuar procedurat e përcaktuara në rregulloret e ARRU-së për evitimin e rrjedhjeve të ujit. Në disa raste specifike, evitimi i defekteve është vonuar për shkak të pamundësisë së furnizimit me pjesë rezervë, veçanërisht në rastet kur defektet kanë ndodhur në gypa të ujësjellësit me profile të mëdha, të cilat kanë ardhur si pasojë e amortizimit të tyre.

Gjatë vitit 2025, ekipi për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit ka evituar defekte në gjithsej 1,470 raste.

Tabela 24. Intervenimet në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjesit

Njësia Operative	Numri i intervenimeve
Gjilan	871
Kamenicë	420
Viti	140
Novobërdë	20
Ranillug	19
<b>Numri total</b>	<b>1,470</b>

Numri i intervenimeve gjatë vitit 2025 ka qenë 1,470, ndërsa në vitin 2024 ka qenë 1,728, që do të thotë se është shënuar një zvogëlim prej 258 intervenimesh.


### 9.2.2 DMA - zonat

Në zonën e shërbimit për regjionin e Gjilanit i kemi (6) gjashtë zona DMA:

1. Lagjen Dardania 1 dhe 2 ;
2. Livoç i Ulët;
3. Kufcë e Epërme;
4. Kmetovc dhe Verbicë e Kmetovcit;
5. Shillovë e Muhaxherëve dhe

Zona më e madhe është ajo ku përfshihen Lagjet e Zabelit, Arbërisë, Velekinca dhe Bregu i Djegun<sup>25</sup>.

Figura 1. Paraqitja grafike e DMA - zonave ekzistuese



<sup>25</sup> Përfshijnë burimet nga 1 deri në 8 të paraqitura në tabelën 26.

Tabela 25. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë vitit 2025 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit

	Burimi	Prodhimi (m <sup>3</sup> )	Faturimi për (m <sup>3</sup> )	UPF (%)
1.	Rr. "Lidhja e Prizrenit" *10	280,959	531,935	50.44
2.	Lagjja "Bregu i Djegun" (te ish kombinati i duhanit)	60,411		
3.	Rr. "Hysen Tërpeza"	56,406		
4.	Lipovicët	112,371		
5.	Mbrapa shkollës në Velekincë DN 63	20,115		
6.	Velekincë DN 90	167,686		
7.	Rr. "Mulla Idrizi"	349,815		
8.	Rr. "Esat Berisha"*10	25,608		
9.	Shillova 1	3,982	7,946	39.98
10.	Shillova 2	9,258		
11.	Kmetovc	60,617	46,077	23.98
12.	Kufcë e Epërme	30,924	19,326	37.5
13.	Livoç i Ultë	130,832	61,445	53.03
14.	Lagjja "Dardania 1" *10	232,139	190,502	51.63
15.	Lagjja "Dardania 2" *10	161,727		
	<b>Prodhimi total m3/vit:</b>	<b>1,701,094</b>	<b>900,431</b>	<b>47.06</b>

Në zonën e shërbimit për regjionin e Kamenicës kemi një zonë DMA:

1. Berivojcë - Lagjja Iliria

Në zonën e shërbimit për regjionin e Vitisë i kemi dy zona DMA:

1. Pozhorani
2. DMA Zonë mbrenda qytetit të Vitisë.

### 9.3. Divizioni i mirëmbajtjes së ujërave të ndotura

#### 9.3.1 Mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit

Ngjashëm me rrjetin e ujësjellësit, edhe sektori i kanalizimit gjatë këtij viti është përcjellë me probleme të konsiderueshme. Edhe pse gjatë vitit 2025 janë bërë investime në blerjen e makinerisë, ende mbetet sfida mungesa e makinerisë së mjaftueshme, si dhe vjetërsia e asaj ekzistuese, e cila, si rrjedhojë, paraqet pengesë në realizimin e të gjitha aktiviteteve. Kjo sfida bëhet edhe më e theksuar duke pasur parasysh se e njëjta makineri shërben për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit në tri komuna.

Gjatë vitit 2025, ekipi për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit ka intervenuar në 1,703 raste dhe në të gjitha rastet ka evituar defektet e paraqitura. Po ashtu, gjatë vitit 2025 është realizuar pastrimi i 5,112 pusetave në tri komunat: Gjiilan, Kamenicë dhe Viti.

Tabela 26. Intervenimet në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe pastrimit të pusetave

Nr	Muaji	Numri i intervenimeve	Numri i pusetave të pastruara
1.	Janar	110	304
2.	Shkurt	125	379
3.	Mars	127	403
4.	Prill	114	300
5.	Maj	155	476
6.	Qershor	126	405
7.	Korrik	152	396
8.	Gusht	136	347
9.	Shtator	159	483
10.	Tetor	190	623
11.	Nëntor	188	528
12.	Dhjetor	121	468
	<b>Total</b>	<b>1,703</b>	<b>5,112</b>

### 9.4. Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve

#### 9.4.1 Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Divizioni për Planifikimin dhe Menaxhimin e Projekteve ka realizuar aktivitetet e paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela 27. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë vitit 2025

	Aktivitet	Numri i aktiviteteve
1.	Pëlqime në parim për banime kolektive dhe afarizëm	51
2.	Pëlqim në parim për banim individual	126
3.	Pëlqim në parim për institucione	13
4.	Evidentimi i intervenimeve në GIS	568
5.	Insertimin e kërkesave të reja për kyçje në rrjetin e ujës-jellësit	248
6.	Vlerësim të ofertave në Prokurim	35
7.	Pranime teknike (punëve) të investimeve në rrjet	2
8.	Incizimi i rrjetit të kanalizimit fekal (pusetave)	680

Përveç aktiviteteve të paraqitura në tabelë, zyrtarët nga Divizioni i Planifikimit janë të angazhuar edhe në projekte të rëndësishme për zhvillimin e kompanisë, të financuara nga organizata ndërkombëtare, si dhe në projekte vetanake, siç janë:

#### 9.4.2 Projektet ndërkombëtare

##### FLAWS (Nxitja dhe shfrytëzimi i mundësive për sigurinë ujore)

Gjatë vitit 2025, projekti FLOWS ka shënuar përparime të dukshme në aspektin administrativ, ndërtimor dhe teknik, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë ujore për zonën e Gjilanit dhe rrethinën. Në fazën fillestare janë siguruar lejet ndërtimore nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Gjilanit për Pakon 1, e cila përfshin ndërrimin e gypave në Linjat 1A, 2B, 3A dhe 3B, si dhe ndërtimin e stacioneve të pompimit Baja dhe Burgu.

Paralelisht, për Rezervuarin në Përlepnice është iniciuar dhe avancuar procesi i shpronësimit, ku është kompletuar dokumentacioni në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe janë siguruar pëlqimet dhe leja përkatëse ndërtimore.

Në kuadër të Pakos 1 janë planifikuar dhe miratuar ndërhyrje në disa linja kryesore të furnizimit me ujë, duke përfshirë Linjën 1A me gjatësi totale 3,600 m, Linjën 2B me gjatësi 1,244 m, si dhe Linjat 3A dhe 3B, së bashku me ndërtimin e stacioneve të pompimit Baja dhe Burgu. Punimet në terren kanë filluar në muajin mars, me fokus fillestar në zonën e bunarit të Përlepnices dhe shtrirjen e gypave DN 630.

Gjatë muajve në vijim, aktivitetet janë zgjeruar në disa segmente të rrjetit, përfshirë rrugët Avdullah Presheva, Medlin Ollbrajt dhe Hamdi Kurteshi, si dhe në fshatin Përlepnice, ku është avancuar ndjeshëm shtrirja e gypave me diametra të ndryshëm. Njëkohësisht, kanë vazhduar punimet në stacionet e pompimit Baja, Burgu dhe Velekincë, duke përfshirë ndërtimin, rrethimin dhe zëvendësimin e pompave ekzistuese.

Në Linjën 1A (DN 630), e cila ka një gjatësi të planifikuar prej 3,600 m, gjatë periudhës raportuese janë instaluar rreth 2,400 m gyp, që përfaqëson afërsisht dy të tretat e gjatësisë totale të linjës. Në rrugën Avdullah Presheva (Linja 2, Seksioni C) janë realizuar punimet e plota për shtrirjen e gypit, ndërsa në rrugën Hamdi Kurteshi (Linja 3, Seksioni B) është përfunduar shtrimi i gypit DN 315 PE.

#### ITUN (Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur)

Gjatë vitit raportues, në kuadër të projektit ITUN janë realizuar aktivitete të rëndësishme administrative, teknike dhe përgatitore, duke krijuar bazë të qëndrueshme për fillimin e fazave ndërtimore. Në kuadër të detyrave të rregullta mujore është përgatitur dhe dorëzuar në BERZH, në bashkëpunim me konsulentin e PIU-së, raporti LALRP (Land Acquisition and Livelihood Restoration Plan) për projektin e ITUZ. Po ashtu është përgatitur shkresa për pajisje me ekstrakt nga Instituti i Planifikimit Hapësinor të Kosovës, si dhe është hartuar dhe dorëzuar plani shumëvjeçar për shpenzimin e fondeve për projektin ITUZ. Një komponentë e rëndësishme ka qenë edhe përgatitja dhe dorëzimi i raportit vjetor mjedisor dhe social për vitin 2024, si dhe koordinimi i vazhdueshëm me komunën e Gjilanit dhe atë të Parteshit për proceset e shpronësimit dhe lejeve të kalimit për rrjetin e kanalizimit.

Në aspektin e prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar vlerësimet teknike për tre tenderë kryesorë: mbikëqyrjen e punimeve, ndërtimin e ITUZ dhe zgjerimin/rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit. Këto vlerësime janë dorëzuar në BERZH, ku është marrë aprovimi përfundimtar për tenderët e mbikëqyrjes dhe rrjetit të kanalizimit, si dhe aprovimi në parim për ndërtimin e ITUZ - Faza I. Në muajin qershor, operatorët ekonomikë fitues për mbikëqyrje dhe ndërtimin e kolektorëve kanë pranuar njoftimet për kontratë dhe ka filluar procesi i negocimit.

Gjatë TM4, aktivitetet janë intensifikuar me përgatitjen e dokumentacionit për leje ndërtimore për kolektorët, finalizimin e raportit për leje mjedisore komunale dhe lansimin e tenderit "Faza 2" për ndërtimin e ITUZ. Është nënshkruar Amendamenti Nr. 1 i kontratës së mbikëqyrjes dhe është mbajtur takimi fillestar me kontraktorin. Në fillim të muajit dhjetor është caktuar data e fillimit, duke shënuar zyrtarisht fillimin e punimeve në terren për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, pas sigurimit të lejeve ndërtimore nga Komuna e Gjilanit.

#### 9.4.3 Projektet vetanake

1. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin "Kycjet e rrugëve apo shtëpive individuale përgjatë kolektorit, fshati Livoç i Epërm - Livoç i Ulët - Kodra e Thatë, me gjatësi 800 m", i cili është konform Planit të Biznesit (PB).
2. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin "Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe rikycjet individuale DN 80 mm AC deri DN 200 mm PE", i cili është i përfshirë edhe në Aneksin e PB 2025-2027.
3. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin "Ndërrimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në rrugën Abdullah Tahiri, me gjatësi L = 450 m", i cili është i përfshirë në PB 2025-2027.

4. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin "Ndërtimi dhe rehabilitimi i rezervuarëve në Kamenicë", konform PB 2025-2027.
5. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin "Kycjet individuale në fshatin Uglar".
6. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për furnizimin me ujëmatës.
7. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektet e aprovuara nga ME, përfshirë projektin "Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kycjet individuale në zonën urbane të Gjilanit - Lagjja Fidanishte II (Projekti i Fidanishtes)".
8. "Furnizimi me ujëmatës, bllokues dhe plomba për ujëmatës".
9. Përpilimi i paramasës dhe parallogarisë, hartimi i detajeve teknike, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin "Ndërtimi i pusetave për DMA - Viti".

#### 9.4.4 Projektet e rëndësishme të KRU "Hidromorava" gjatë vitit 2025

Tabela 28. Raport mbi statusin e disa prej projekteve të rëndësishme të menaxhuara nga KRU "Hidromorava" Sh.A.

Nr.	Projekti	Data e kontratës	Vlera totale e kontratës	Vlera e punimeve të përfunduara deri 31.12.2025	Statusi i punimeve
1.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnice", Komuna e Gjilanit	25.07.2025	750,216.36€	386,849.12€	Deri më tani ka përfunduar 52% e vlerës së projektit dhe do të vazhdoj deri në fund të vitit 2025.
2.	"Hartimi, ndërrimi i gypave dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit brenda zonës së shërbimit"	28.03.2024	177,655.80 €	78,914.80 €	Punimet për këtë projekt kanë filluar gjatë vitit 2024 dhe po vazhdojnë edhe në vitin 2025, me mbi 90% të punimeve të përfunduar deri më tani.

3.	"Ndërtimi i rrjetit të ujës-jellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës"	21.11.2024	443.539.85€	222,871.00 €	Punimet për këtë projekt planifikohet të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2026, ndërsa deri në fund të vitit 2025 është realizuar 51% e vlerës së përgjithshme të projektit.
4.	"Ndërtimi i rrjetit të ri të ujës-jellësit dhe kalimi i kyçjeve individuale të konsumatorëve nga Gypat AC në atë HDPE"	14.06.2024	103,105.00 €	91,032.70 €	Deri më tani, projekti është përfunduar 100%, ndërsa aktualisht po realizohet kompletimi i dokumentacionit dhe dorëzimi i faturës për pagesë. Është përfunduar instalimi i gypit DN 315 në Linjën 3B, në rrugën Hamdi Kurteshi. Në Linjën 1, Seksioni A, është realizuar deri më tani instalimi i 2/3 të segmentit të gypit DN 630 mm. Janë vendosur pajisjet për monitorim SCADA dhe aktualisht po punohet në rregullimin e komunikimit. Tek rezervuari 3,500 m <sup>3</sup> në Përlepnicë, puna është në vazhdim e sipër. Gjatë muajit dhjetor janë zhvilluar punime paralelisht në instalimin e gypave të rrjetit të ujës-jellësit në rezervuarin e Përlepnicës, si dhe në stacionet e pompimit. Në Linjën 1, Seksioni A janë instaluar 260 m gyp DN 630 mm, në Linjën 2B janë instaluar 350 m gyp DN 315 mm, në stacionin e pompimit Velekincë është bërë zëvendësimi i pompave dhe instalimi i pjesëve përcjellëse elektrike, ndërsa tek rezervuari i Përlepnicës ka filluar përgatitja e armaturës së pllakës dhe hidroizolimi.
5.	"Projekti FLOWS – Faza e parë e tenderimit"	21.01.2025	5,900,000.00 €		Deri më tani, projekti është përfunduar 100%, ndërsa aktualisht po realizohet kompletimi i dokumentacionit dhe dorëzimi i faturës për pagesë. Është përfunduar instalimi i gypit DN 315 në Linjën 3B, në rrugën Hamdi

					<p>Kurteshi. Në Linjën 1, Seksioni A, është realizuar deri më tani instalimi i 2/3 të segmentit të gypit DN 630 mm. Janë vendosur pajisjet për monitorim SCADA dhe aktualisht po punohet në rregullimin e komunikimit. Tek rezervuari 3,500 m<sup>3</sup> në Përlepticë, puna është në vazhdim e sipër. Gjatë muajit dhjetor janë zhvilluar punime paralelisht në instalimin e gypave të rrjetit të ujës-jellësit në rezervuarin e Përlepticës, si dhe në stacionet e pompimit. Në Linjën 1, Seksioni A janë instaluar 260 m gyp DN 630 mm, në Linjën 2B janë instaluar 350 m gyp DN 315 mm, në stacionin e pompimit Velekincë është bërë zëvendësimi i pompave dhe instalimi i pjesëve përcjellëse elektrike, ndërsa tek rezervuari i Përlepticës ka filluar përgatitja e armaturës së pllakës dhe hidroizolimi.</p>
6.	"Projekti ITUN"	28.05.2019	24,500,000 €		<p>Fillimi i punëve në terren për rehabilitimin dhe zhvillimin e rrjetit të kanalizimit: Kompania është mobilizuar dhe ka filluar punimet në terren në fund të muajit dhjetor. Janë siguruar lejet mjedisore komunale nga Komuna e Gjilanit, si dhe është bërë aplikimi dhe marrja e lejeve ndërtimore për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit. Në kuadër të fazës së dytë të projektit, janë hapur ofertat për ndërtimin e ITUN-së dhe ka filluar vlerësimi i tyre nga komisioni vlerësues. Gjithashtu, janë pranuar faturat e avansit për kontratat e nënshkruara dhe është bërë harmonizimi i dokumenteve për disbursim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e</p>

7.	"Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE"	12.03.2025	257,080.79 €	117,731.84 €	Pas nënshkrimit të kontratës, Operatori Ekonomik ka filluar zëvendësimin e gypave nga AC në PE, në përputhje me planin dinamik të dorëzuar. Deri më tani, është realizuar 46% e projektit.
8.	"Kyçjet (e rrugëve apo shtëpive individuale) përgjatë kolektorit fshati Livoç i Epërm – Livoç i Ulët – Kodra e Thatë, gjatësi 800m"	25.04.2025	32,476.00 €	22,953.80 €	Deri më tani është realizuar 70% e vlerës së përgjithshme të projektit.
9.	Kyçjet individuale në fshatin Uglar të komunës së Gjilanit	20.11.2025	60,602.50	21,368.00 €	Deri më tani është realizuar 35% e projektit.
10	"Projekti FLOWS – Faza e dytë e tenderimit"	08.09.2025	6,423,669.80	1,201,177.88	Letnica dhe ndërrimi i gypave në Kamenicë: Në Kamenicë, punimet kanë filluar më datë 22.12.2025 dhe deri në fund të muajit dhjetor janë instaluar rreth 200 m gyp në segmentin e rrugës Adem Jashari

Kryeshefi Ekzekutiv


  
 z. Ymer Salihu


U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve


  
 z. Habil Zeqiri



Kompania Rajonale e Ujësjetësimit  
"Hidromorava"  
Gjilan

### NA KONTAKTONI:



Rr. Vëllezrit Gërvalla, Nr. 71  
Gjilan, Kosovë



info@hidromorava.com



0800 61 000



[www.kru-hidromorava.com](http://www.kru-hidromorava.com)